



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM ELBASAN

NR 303 AKTI

ELBASAN 01/08/2024

SH P A L L J E

Prane kesaj gjykate eshte gjykuar ceshtja CIVILE me nr vendimi 958 DT 10/07/2024, qe I perket paleve ndergjyqese PADITES ERNOLDA KUOCKA(SHAHINI) DHE PADITUR BLEDION KUOCKA, ME OBJEKT "NDREQJE GABIMI"

Sipas KONFIRMIMIT REZULTON SE BLEDION KUOCKA ESHTË LARGUAR .

Hartohet kjo shpallje ne tre kopje ,ku njera afishohet ne porten e gjykates,tjetra qendron ne dosje dhe e treta afishohet NE NJESISE ADM .VRESHTAS,SHEQERAS,MALIQ..

K.SEKRETARE

LINDITA CELA

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA RRETHIT ELBASAN.

NJESISE ADM.VRESHTAS,SHEQERAS,MALIQ

Bashkengjitur shkreses po j'u dergojme nje kopje te vendimit CIVIL nr 958 dt 10/07/2024 I cili ze vendin e komunikimi NDAJ BLEDION KUOCKA.

K /SEKRETARE

LINDITA CELA

Adresa: Lagja 5 Maj, Rruga koço Brisku Elbasan, Shqipëri, Tel: +355 54 25 99 51, www.gjykata.gov.al

-Yj A-Vreshtas
-STIMP
05.08.2024

Gjykata, pasi shqyrtoi pretendimet e përfaqësuesit të palës kërkuese, që kërkoj pranimin e kërkesës sipas objektit, dhe si administroi provat shkresore dhe shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,

VËREN:

1. Se pala kërkuese ka paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan kërkesën me objekt ndreqjen e gabimit material në vendimin nr. 264 (13-2024-842), datë 21.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, që lidhet me të dhënat personale të palës kërkuese, të vendosura në hyrje të vendimit, konkretisht sa i takon atësisë së saj.
2. Gjykata, pasi studioi materialet e çështjes për gjykim, në bazë të nenit 36 të K.Pr.Civile, çmoi kryesisht se çështja e paraqitur është në juridiksionin gjyqësor. Përsa i përket kompetencës lëndore, mbështetur në nenin 41 të K.Pr. Civile, duke qenë se çështja e paraqitur për shqyrtim është një mosmarrëveshje civile, Gjykata është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.
3. Lidhur me kompetencën tokësore, në bazë të nenit 42, 312 të K.Pr. Civile, Gjykata është kompetente edhe nga pikëpamja e kompetencës tokësore, për të marrë në shqyrtim çështjen civile objekt gjykimi.
4. Në seancën gjyqësore datë 10.07.2024, u paraqit përfaqësuesi i kërkuësës Ernolda Kuoçka (Shahini) ndërsa nuk u paraqit personi i interesuar Bledion Kuoçka.
5. Në kërkesën objekt gjykimi dhe në parashtrimet e dhëna në seancën gjyqësore, përfaqësuesi i kërkuësës pretendoi se pasi kanë marrë dijeni për vendimin nr. 264 (13-2024-842), datë 21.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, kanë konstatuar një pasaktësi materiale në të dhënat personale të palës kërkuese. Konkretisht në pjesën hyrëse të gjenealiteteve të palës kërkuese, Ernoda Kuoçka (Shahini), që evidentohet si palë paditëse në atë vendim, rezulton se është bërë një gabim material në atësinë e saj konkretisht atësia është referuar "Reshat", ndërkohë që emri i saktë i babait të saj është "Reshit".
6. Përfaqësuesi pretendoi se kjo e dhënë provohet lehtësisht nga provat e paraqitura e aktet e administruara në dosjen gjyqësore të zgjidhjes së martesës. Për sa më sipër, gabimi i konstatuar është një gabim i natyrës së pastër materiale dhe teknike, si dhe korrigjimi i tij nuk ndikon në përmbajtjen e vendimit, por ka të bëjë thjesht me një gabim në shkrimin e vendimit, prandaj kërkohet korrigjimi i gabimit material të vendimit lidhur me atësinë e palës kërkuese, palë paditëse në atë gjykim mbi bazën e të cilit është disponuar me vendimin nr. 264 (13-2024-842), datë 21.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan .
7. Për sa më sipër si dhe bazuar në nenet 312 të Kodit të Procedurës Civile, pala kërkuese ka kërkuar pranimin e kërkesës dhe ndreqjen e gabimeve materiale.
8. Pasi u njoh me pretendimin e kërkuësës, gjykata konstatoi se kërkesa e paraqitur është e drejtë dhe e bazuar në ligj.
9. Nga ana e gjykatës u tërhoq nga arkiva, fashikulli i çështjes civile me nr. 896 (21001-00078-13) regj them., datë regjistrimi 18.01.2024 në të cilën është disponuar me vendimin nr. 264 (13-2024-842), datë 21.02.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm

1. Pranimin e kërkesës së palës kërkuese Ernolda Kuoçka (Shahini) me objekt "Ndreqje gabimi material në vendimin nr. 264 (13-2024-842), datë 21.02.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan".
2. Korigjimin e gabimit material të bërë në vendimin nr. 264 (13-2024-842), datë 21.02.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, përsa i përket pjesës hyrëse të vendimit që lidhet me gjenealogjetet e palës paditëse Ernolda Kuoçka, palë kërkuese në këtë gjykim, konkretisht sa i takon atësisë e cila nga: "Ernolda Kuoçka, atësia Reshat" bëhet "Ernolda Kuoçka, atësia Reshit".
3. Ky vendim i bashkëlidhet dosjes së themelit që i përket vendimit nr. 264 (13-2024-842), datë 21.02.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës kërkuese.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke filluar nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyeshuar.

U shpall në Elbasan, sot më datë 10.07.2024

SEKRETARE

TEUTA MEZINI

GJYQTARE

AURORA ALIMADHI



POSTA E L. BASAN
TARIFE MARRE

